

GEORGI GOSPODINOV

KOHËSTREHIM

Roman

BOTIMET TOENA

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale e Evropës, Integritimit dhe Punëve të Jashtme në Republikën e Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni Zviceran Pro Helvetia, Grupi i Interesit të Përkthyesve dhe Përkthyesve (Shtëpia e Letërsisë Vjenë) me porosi të Ministrisë Federale të Artit, Kulturës, Shërbimeve Publike dhe Sportit në Republikën e Austrisë, Instituti Goethe, Agjencia Sllovene e Librit, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe Informacionit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Kulturës e Republikës së Bullgarisë, Panairi i Librit në Lajpcig dhe Fondacioni S. Fischer.

traduki

GEORGI GOSPODINOV

KOHËSTREHIM

Roman

Përktheu nga origjinali bullgarisht
Milena Selimi



BOTIMET TOENA
Tiranë

Autori: Georgi Gospodinov
Titulli në origjinal: Vremeubezhishte
Botoi në bullgarisht: Janet 45, Bullgari

Një pjesë e këtij romani është punuar në rezidencën letrare “Split 2024”, mbështetur nga Association KURS, si pjesë e programit “Writers in Residence”.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi
Redaktor letrar: Eris Rusi
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Erdita Oshafi

ISBN 9789928817648


© e përkthimit: Fondacioni S. Fischer me porosi të TRADUKIT
© Georgi Gospodinov, 2020
© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
Email: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al>


*Nënës dhe babait tim
që akoma pastrojnë nga barërat e këqija
fushat e përjetshme me luleshtrydhe
të fëmijërisë.*

Të gjitha personazhet në këtë roman janë të trilluara,
të vërtetë janë vetëm të trilluarit.



Përmbajtja

I. Klinikë për të shkuarën	15
II. Vendimi	131
III. Një vend i marrë veçmas	151
IV. Referendum për të shkuarën	237
V. Përbindësha të fshehtë	279
Epilog	331



Akoma askush s'ka shpikur një maskë kundërgaz dhe strehim antibombë kundër kohës.

Gaustin, “Kohëstrehimi”, 1939

Por, cili është organi ynë për kohën? A mund të ma thuash¹?

Thomas Mann “Mali Magjik”

Njeriu është e vetmja makinë e kohës, që zotërojmë.

Gaustini “Kundër Utopive”, 2001

Sikur të mos ishin ditët ku do të jetonim...²

Philip Larkin “Ditët”

¹ Përkthim nga gjermanishtja i Todor Berberov.

² Përkthim nga anglishtja Nikolaj Popov.

Oh yesterday suddenly...

Lennon/McCartney

... Sikur rruga të ishte koha, ndërsa ai - në fundin tjetër të saj³.

T.S. Eliot "Lajmet e mbrëmjes së Bostonit"

Kjo e djeshmja jonë e përjetshme, dje...dje...

Gaustin/Shakespeare

Romani vjen me urgjencë, me drita të ndezura dhe sirena të hapura.

***Gaustine Emergency Novel
Brief Theory and Practice***

³ Përkthim nga anglishtja Vladimir Levcev.

... Edhe Zoti do ta thërrasë mbrapsht të shkuarën.

Ecclesiastes (3:15)

*E shkuara dallohet nga e tashmja nga një gjë thelbësore -
kurrë s'rrjedh në një drejtim.*

Gaustin "Fizika e së shkuarës", 1905

*Njëherë kur ishte e vogël vizatoi një kafshë, krejt të
panjohur.*

- Çfarë është kjo, - pyeta.

*- Ndonjëherë është peshkaqen, ndonjëherë luan dhe
ndonjëherë një re, - u përgjigj ajo.*

- Ah, por çfarë është tani saktësisht?

- Tani është një vendstrehim.

G.G "Fillime dhe mbarime"

I.

KLINIKË PËR TË SHKUARËN



Kështu pra, tema është kujtesa. Tempo: nga andante drejt andante moderato, sostenuto (e përmbajtur). Ndoshta vallëzimi sarabanda me solemnitetin e përmbajtur, me kohën e dytë të zgjatur, mund të kishte qenë e mirë për fillim. Më shumë Hendel, sesa Bach. Një përsëritshmëri rigoroze dhe në të njëjtën kohë lëvizje përpara. E përmbajtur dhe solemne, siç duhet në fillim dhe pastaj gjithçka mundet dhe duhet të shpërbëhet.

1.

Në një moment ata nisën të llogaritnin kur filloi koha dhe kur është krijuar Toka saktësisht. Peshkopi irlandez Ussher, nga mesi i shekullit të VII-të përlllogariti jo vetëm vitin konkret, por edhe datën e fillimit: 22 tetor, viti 4004 përpara Krishtit. Binte e shtunë (kuptohet). Sipas disave Ussher-i tregon me saktësi edhe orën, diku andej nga ora 6 pasdite. E shtunë pasdite, e besoj absolutisht. Në ç'kohë tjetër të javës një krijues i mërzitur do të niste të ndërtonte botën dhe të kërkonte shoqëri? Kësaj ia ka kushtuar Ussheri të gjithë jetën e tij, vepra numëronte dymijë faqe latinisht, pak e besueshme kjo, se janë shumë ata që janë lodhur ta lexojnë të gjithën. Por ama ajo ishte bërë jashtëzakonisht e njohur, ndoshta jo vepra, por zbulimi. Në Ishull, Bibla fillon të botohet me datë dhe kronologji, sipas Ussher-it. Kjo teori për tokën më të re (sipas meje për kohën e re) pushtoi botën e krishterë. Duhet të themi se shkencëtarë si Kepleri dhe sër Isaac Newton përmendin vite konkrete të veprës së Zotit, pak a shumë rreth kësaj date të Ussher-it. Por, megjithatë, për mua, më e mahnitshmja s'është viti kaq i ri por dita konkrete.

22 tetor, katërmijë e katër vjet përpara Krishtit.

Ndokund, rreth dhjetorit të vitit 1910 pak a shumë, karakteri njerëzor ndryshoi. Kështu shkruan Virginia Woolf. Dhe s'është vështirë të imagjinohet ai dhjetor i vitit 1910 në dukje i ngjashëm si gjithë të tjerët, gri dhe me erën e borës së parë. Por diçka kishte ndodhur, diçka që vetëm disa e patën ndjerë.

Më 1 shtator të vitit 1939 herët në mëngjes, kohës njerëzore i erdhi fundi.

2.

Vite më vonë, kur shumë nga kujtimet e tij do të fluturonin si pëllumba të trembur, ai mund t'ia kthente vetes atë mëngjes kur ecte pa qëllim në rrugët e Vjenës, ndërsa një endacak me mustaqet si Gabriel Márquez shiste gazeta në trotuar nën diellin e parë të marsit. Nisi era dhe disa gazeta u ngritën në ajër. Ai u përpoq t'i mbajë, kapi dy-tri dhe i ktheu në vend.

- Mund të mbani një, - i tha Márquez-i.

Gaustin, kështu do ta quajmë, megjithëse ai vetë këtë emër e përdorte si një kapele që e bënte të padukshëm, e palosi gazetën dhe zgjati një kartëmonedhë, goxha të madhe kundrejt rrethanës. Endacaku e mori ndër duar dhe tha: Por, s'kam t'ju kthej kusur.

Kjo tingëlloi kaq absurde në mëngjesin e hershëm vjenez, saqë qeshën të dy. Ndaj të pastrehëve, Gaustini ndjente dashuri dhe frikë, këto ishin fjalët, gjithmonë

bashkë. I donte dhe kishte frikë prej tyre në atë mënyrën si dashuron dhe frikësohesh njëherësh prej asaj gjëje që ke qenë dikur, ose që pret të bëhesh një ditë. E dinte se herët ose vonë do të shkrihej në armatën e tyre, në qoftë se do të përdorim klisenë. Imagjino për një çast rreshtat e gjatë të të pastrehëve që parakalojnë në rrugët “Kärntner” dhe “Graben”. Po, sipas fisit, ai ishte njëri prej tyre, megjithëse pak më i veçantë. Thënë ndryshe, i pastrehi i kohës. Thjesht, falë rrethanave, u gjend me disa para, të mjaftueshme për të larguar shndrrimin e fatkeqësisë metafizike në vuajtje fizike.

Për momentin ushtronte njërin nga profesionet e tij, atë të psikiatrit gjerontolog¹. Dyshoja se ai rrëmbente fshehurazi historitë e pacientëve për t’u strehuar, për të qëndruar për pakëz në vendin e të shkuarës së dikujt tjetër. Përndryshe në kokën e tij kishte kaq shumë formacione kohërash, zërash dhe vendesh, saqë, nevojitej, ose të dorëzohej pa vonesë në duart e kolegëve të tij psikiatër, ose do të katranoste gjëra që t’i detyronin ata vetë ta mbyllnin në çmëndinë.

Gaustini mori gazetën, eci pak dhe u ul në një stol. Mbante një borsalinë, një pardesy të errët ku spikaste golfi që i mbulonte fytyrën, një palë këpucë të vjetra lëkure dhe një çantë lëkure me një ngjyrë të kuqe fisnike që po venitej

¹ Gjerontologjia është studimi i plakjes dhe i të moshuarve. Shkenca e gerontologjisë është zhvilluar me rritjen e jetëgjatësisë. Studiuesit në këtë fushë janë të larmishëm dhe janë të trajnuar në fusha të tilla si fiziologjia, shkencat sociale, psikologjia, shëndeti publik dhe politikat (të gjitha shënimet në vijim janë nga përkthyesja).

pak e nga pak . Ngjasonte si një njeri i sapoardhur me tren nga një dhjetëvjeçar tjetër, mund ta merrje si një anarkist diskret, si një *hipi* i moshës së tretë, ose si predikues i një urdhri fetar pak të njohur.

Kështu, u ul në stol dhe lexoi emrin e gazetës, “Augustin”, botim i të pastrehëve. Një pjesë e gazetës shkruhej prej tyre e një tjetër nga gazetarët. Diku poshtë, në faqen e parafundit, në cepin e majtë, vendi më i padukshëm i një gazete, që dihej nga të gjithë botuesit, gjendej shënimi. Ia tërhoqi vëmendjen. Në fytyrën e tij u shfaq një buzëqeshje e lehtë, ku më shumë kishte hidhërim, sesa gëzim. Do t’i duhej të zhdukej sërish.

3.

Përpara ca kohësh, kur zoti Alzheimer përmendej akoma nëpër anekdota çfarë diagnoze të dhanë, epo ishte një emër i një burri, por e harrova, në një gazetë të vogël doli një artikull i shkurtër. Ishte nga ato lajme që pesë veta i lexojnë e katër i harrojnë.

Ja shënimi i treguar shkurtimisht.

Një mjek, doktor G. (shkruar vetëm me inicial) nga klinika gjeriatrike vjeneze në Wienerwald, fans i Beatles, mobiloi kabinetin e tij në stilin e viteve ’60-të. Ai gjeti një gramafon bakeliti, vari në mur pllakate të famshme të grupit, si *Sergeant Pepper*... bleu një dollap në pazarin e sendeve të vjetra dhe rreshtoi brenda lloj-lloj xhinglash të viteve ’60 si: sapunë, kuti cigaresh, një seri miniature

Volkswagen, cadillac, mustang, afishe filmash, aktorësh. Shkruhej se tavolina e punës së tij ishte mbushur me revista të vjetra, kurse ai vetë qëndronte ulur, veshur me përparësen e bardhë dhe golfin poshtë. Kuptohet, s’kishte foto, i gjithë lajmi përbëhej nga tridhjetë rreshta, i ngjeshur në cepin e majtë, poshtë. Thelbi i lajmit ishte se mjeku kishte vërejtur sesi pacientët me probleme të kujtesës rrinin gjithmonë e më gjatë në kabinetin e tij, flisnin gjithmonë e më shumë, thënë ndryshe, ndiheshin rehat. Kështu, përpjekjet për arratisje nga kjo klinikë e njohur ishin pakësuar në mënyrë radikale.

Lajmi s’kishte autor, por ishte në emër të gazetës.

Kjo ishte ideja ime, e pata mbajtur në kokë prej vitesh, por siç duket qartë, dikush ma paska kaluar. (Duhet ta pranoj, se ideja ime ishte për një roman, jo për një klinikë, por njësoj është). Këtë gazetë të pastrehësh e merrja kur më binte rasti, nga njëra anë për lidhjen e veçantë me ata që e botonin, histori e gjatë kjo, që vjen nga një roman tjetër, por edhe nga ndjesia e qartë (besëtytni personale), se pikërisht në këtë mënyrë, përmes një copë gazete ajo që është për t’u thënë vjen papritmas tek ty, ose të plasit përpara syve. Kjo ndjesi s’më ka zhgënjyer kurrë.

Gazeta shkruante se klinika ndodhet në pyllin vjenez dhe asgjë më shumë. Verifikova ku ndodheshin qendrat gjeriatrike përreth, të paktën tri prej tyre ndodheshin aty. Ajo që më duhej, siç e donte rregulli, më doli e fundit. U paraqita si gazetar, në fakt gënjeshtër s’ishte aq e madhe, e kisha kartën nga një gazetë, për të cilën edhe shkruaja ndonjëherë, kartë me të cilën hyja nëpër muzeume. Në raste

të tjera përdorja profesionin e përafërt të shkrimtarit, shumë më pak të rrezikshëm dhe të manovrueshëm, me të cilin nuk ke si të legjitimohesh.

Megjithatë, me pak vështirësi, arrita të takoj drejtoreshën e klinikës. Kur ajo mësoi qëllimin e interesimit tim, u bë e pakomunikueshme. Personi që kërkoni, nga dita e djeshme, s'është më i pranishëm. Përse? U largua me pëlqimin e të dyja palëve, u përgjigj ajo, duke hyrë në fushat rrëshqitëse të gjuhës burokratike. E keni pushuar? - u habita sinqerisht. Ju thashë, me mirëkuptim të përbashkët. Përse interesoheni? Para një jave lexova një material interesant në gazetë... Qëkur po shqiptoja frazën, ndjeva se po bëja gabim. Ai lajmi me përpjekjen për arratisje nga klinika? Nga ana jonë ne kemi bërë një kërkesë për përgënjeshtim. Kuptova se s'kishte përse të rrija më shumë, kuptova dhe shkakun për largimin me pëlqim të përbashkët. Si e kishte emrin mjeku, iu drejtova në ikje, por ajo tashmë fliste në telefon.

Nuk u largova menjëherë nga klinika, zbulova korridorin me kabinetet dhe pashë një punëtor tek hiqte tabelën nga dera e tretë djathtas. Kuptohet se ai ishte emri. Gjë që e dyshoja që në fillim.

4.

Të kapësh gjurmën e Gaustinit, i cili kalon nga një dhjetëvjeçar në tjetrin, siç ndërrojmë ne fluturimet aeroporteve, është një shans që të jepet njëherë në njëqind vjet. Gaustinin, të cilin fillimisht e shpika, pastaj e takova

trup e shpirt, ose ishte e kundërta, s'më kujtohet. Miku i padukshëm, më i dukshëm dhe real sesa vetë vetja ime. Gaustini i rinisë sime. Gaustini i ëndrrës sime, të jem dikush tjetër, tjetërkund, të jetoj një kohë tjetër dhe dhoma të tjera. Kishim një obsesion të përbashkët për të shkuarën. Ndryshimi ishte i vogël, por thelbësor. Unë mbetësja i huaj kudo, ndërsa ai ndihej njësoj mirë në të gjitha kohërat. Unë trokisja në dyert e viteve të ndryshme, ndërsa ai tashmë ishte atje, më hapte derën, më fuste brenda dhe zhdukej.

Kur e thirra për herë të parë Gaustinin, ishte për të firmosur tri rreshta, të cilat më erdhën ja ashtu si prej askundit, sikur prej një kohe tjetër. U mundova muaj të tërë dhe s'arrita t'u shtoj asgjë më shumë.

Trubaduri është shpikur nga gruaja

Mund ta përsëris prapë

Ajo ka shpikur Krijuesin

Një natë pashë në ëndërr emrin e shkruar mbi një kopertinë prej lëkure: *Gaustini nga Arli*, shekulli XIII-të. Më kujtohet se akoma nëpër gjumë i thashë vetes: kjo është. Pastaj u shfaq Gaustini vetë, dua të them njëri që i ngjante dhe të cilin ashtu e quajta me vete edhe për veten time.

Ka qenë nga fundi i viteve '80. Diku duhet ta kem ruajtur këtë histori.

5.

GAUSTIN. NJOHJE.

Ja si preferoj t'ua prezantoj. Për herë të parë e pashë në det, në një nga seminaret tradicionale letrare, të shtatorit të parë. Një mbrëmje ishim ulur në një restorant të vogël në breg të detit, të gjithë njerëz të letrave, të pamartuar dhe pa asnjë libër të botuar, në moshën e këndshme midis njëzet e njëzet e pesë vjeç. Kamerieri mezi arrinte të shkruante gotat e rakisë, sallatat e përziera dhe ato me djathë të bardhë përsipër. Kur ne pushuam, për herë të parë u dëgjua i riu që ishte ulur në cep të tavolinës së gjatë, i cili s'kishte arritur të porosiste gjë akoma. Një *smetana*,² ju lutem!

E shqiptoi me bindjen e njeriut, i cili porositi më të paktën një rosë me portokaj, ose *Curacau Blue*. Në heshtjen e gjatë që pasoi, dëgjoje vetëm sesi era e lehtë e mbrëmjes që vinte nga deti rrokulliste një shishe plastike bosh. Si thatë? - arriti të pyeste kamerieri. Një *smetana*, ju lutem, përsëriti ai me të njëjtin dinjitet si më parë. Edhe ne ishim të habitur, por shumë shpejt bisedat u kthyen në tavolinë po aq të zhurmshme si më parë. S'kaloi shumë dhe mbulesa e tavolinës u zhduk mes pjatash e gotash. E fundit që solli kamerieri ishte një pjatë e vockël porcelani me viza të arta anash, Në mes të pjatës së vogël dukej bukur, (ose siç m'u duk mua), *smetana* e porositur. Gaustini e pinte aq ngadalë e me gllënjëza, sa që i mjaftoi përgjatë gjithë mbrëmjes.

² Krem i bardhë me qumësht, që përdoret për gatime apo ëmbëlsira.

Ky ishte takimi ynë i parë.

Ditën tjetër u përpoqa të afrohem me të dhe, për kohën e mbetur, më pak se një javë, e harruam fare seminarin. Të dy s'ishim shumë të gojës, kështu që e kaluam për mrekulli kohën, me shëtitje dhe not, në një heshtje të ndërsjellë. Arrita të mësoj se jetonte vetëm, babai kishte kohë që i kishte vdekur, kurse nëna e tij, përpara një muaji kishte ikur në mënyrë ilegale, për herën e tretë dhe ai shpresonte shumë se, kësaj here, do t'ia dilte të mbërrinte në Amerikë. Gjithashtu kuptova se ai ndonjëherë shkruante histori nga fundi i shekullit të kaluar, pikërisht kështu u shpreh dhe unë mezi e mbajta kureshtjen duke dhënë pamjen e njeriut se kjo është diçka normale. Atë e interesonte shumë e kaluara. Shkonte nëpër shtëpi të vjetra të braktisura, gërmonte ndër rrënoja, pastronte tavane, sëndukë dhe mblidhte lloj-lloj vjetërsirash. Herë pas here arrinte të shiste diçka, qoftë në dyqane antikuarësh, qoftë të njohurve dhe kështu, me këtë, e mbante veten. Mendova se porosia modeste e asaj mbrëmjeje tregonte mundësitë që të jepte ky lloj biznesi. Andaj, mes të tjerash, kur tha se kishte tri paketa cigare "*Thomasion*" të vitit 1937, cilësi ekstra e dyfishtë, të pa pluhurosura, vendosa t'i blija të treja menjëherë. Vërtet, tha ai. Unë gjithmonë kam ëndërruar të provoj një *Thomasion* kaq të regjur, iu përgjigja dhe ai menjëherë vrapoi në shtëpizën e tij. Më shihte me kënaqësi të veçantë sesi unë e ndizja me një shkrepëse origjinale gjermane, të vitit 1928 (dhuratë e tij për cigaret) dhe më pyeste se si më dukej fryma e '37-tës. Djegëse, ia ktheja unë. Cigaret me të vërtetë ishin të forta, pa filtër dhe lëshonin një goxha tym. Kjo me siguri për arsye të bombardimeve të atij viti mbi Guernikë, tha

me zë të ulët Gaustini. Unë mendoj se ndoshta mund të jetë edhe për shkak të aerostatit “Hindenburg” që ishte Zeppelinin më i madh në botë dhe që shpërtheu më 6 maj, 1937, me 100 metra mbi tokë, përpara se të ulej, me 97 persona në bord. Atëherë të gjithë fotoreporterët qanin në transmetim. Këto gjëra me siguri u ngjiten gjetheve të duhanit...

E fika cigaren, por s’thashë asgjë. Ai fliste si dëshmitar okular, i cili me shumë përpjekje ka arritur ta kapërcejë ngjarjen.

Vendosa të ndryshoj menjëherë temën dhe, atë ditë, për herë të parë, e pyeta për emrin. Më thirr Gaustin, tha e më buzëqeshi. Gëzohem, iu përgjigja unë, duke vazhduar shakanë. Unë jam Ismaili iu përgjigja për të vazhduar batutën. Por ai sikur nuk më dëgjoi, tha se i pëlqente ajo poezia me epigrafin e Gaustinit, më pëlqeu, e pranoj. Dhe përveç kësaj, ai vazhdoi serioz, i bashkon të dy emrat e mi Augustin-Garibaldi. Kështu ata të mitë, nuk u morën vesh për emrin. Babai im kërkonte me ngulm që unë të pagëzohesha Garibaldi, ishte një admirues i flaktë i tij. Nëna ime këmbëngulte për Gaustin, si një grua e qetë dhe inteligjente, një admiruese e deklaruar e shenjtorit Augustin, me tri semestra të filozofisë në Universitet, ajo këmbëngulte që ata të shtonin emrin e shenjtorit. Ajo vazhdon të më thërrasë Augustin, kurse babai im, sa ishte gjallë, Garibaldi. Kështu u bashkuan teologjia e hershme dhe revolucionarizmi i vonë. Në vija të përgjithshme me kaq mbaronte informacioni konkret që shkëmbyem gjatë pesë-gjashtë ditëve të seminarit që po shkonte drejt përfundimit. Mbaj mend, sigurisht disa heshtje, veçanërisht të rëndësishme, por nuk mund t’i

ritregoj. Ah po, pati një bisedë tjetër të shkurtër ditën e fundit. Vetëm atëherë e kuptova se Gaustini jetonte në një shtëpi të braktisur, në një qytet të vogël rrëzë malit Ballkan. Nuk kam telefon, tha ai, por letrat vijnë. M'u duk tepër i vetmuar dhe...pa përkatësi. Kjo ishte fjala që më erdhi atëherë. Pa përkatësi ndaj asgjëje në botë, ose më mire ndaj botës së sotme. Shihnim perëndimin bujar të diellit dhe heshtnim. Nga ferrat pas nesh u ngrit një re e tërë mizash të vogla. Gaustini i ndoqi me shikim dhe tha: Nëse për ne ky është thjesht një perëndim, për këto krijesa njëditëshe ky perëndim është perëndimi i jetës së tyre. Ose, diçka e ngjashme. Marrëzi, thashë, se kjo është vetëm një metaforë e konsumuar. Ai më pa i habitur, por s'foli. Vetëm pas disa minutash tha: Tek ato s'ka metafora.

...Gjatë tetorit dhe nëntorit të vitit 1989 ndodhën shumë gjëra, të cilat tashmë janë shkruar dhe përshkruar deri në dhimbje. Mbete shesheve dhe kështu ndodhi që nuk i shkrova Gaustinit. Pata edhe problema të tjera, po përgatisja librin tim të parë, u martova. Sigurisht, të gjitha justifikime idiothe kuptohet. Por, gjatë kësaj kohe shpesh ndërmendesha për të. Edhe ai s'shkruate.

Kartolinën e parë e mora pikërisht më 2 janar të vitit 1990. Ishte një kartolinë e hapur Krishtlindjeje, me një Borëbardhë bardh'e zi, të ngjyrosur prej tij që të kujtonte Judy Garland. Në dorë mbante një shkop të vogël magjik drejtuar vitit 1929, shkruar me shkronja të mëdha. Në pjesën e pasme ishte adresa dhe një urim i shkurtër, shkruar

me bojë sipas drejtshkrimit të atëhershëm, me ë³ dhe e-në e dyfishtë. Përfundonte me “Guxoj ta quaj veten Gaustini yt”.

Menjëherë u ula dhe ia ktheva përgjigjen me një letër, ku e falenderoja për surprizën e këndshme dhe i shkrova se vërtet e vlerësoja mistifikimin e tij me aq finesë.

Po atë javë mora përgjigjen. E hapa me kujdes. Brenda kishte dy fletë filigrani në letër, ngjyrë jeshile e zbehtë, të shkruara vetëm në njërën anë me të njëjtin shkrim të bukur, dhe, nëse s’gaboj, i përmbahej drejtshkrimit të vjetër Omarçevski të viteve ’20.

Më shkruante se s’dilte nga shtëpia, por se ndihej shkëlqyeshëm. Ishte abonuar në gazetën e përditshme “Zora”, që botohej “mjaft objektivisht” nga z. Krapçev, dhe në revistën “Zlatorog”, për të ndjekur gjithsesi nga shkante letërsia. Më pyeste se si e shihja pezullimin e Kushtetutës dhe shpërndarjen e parlamentit nga mbreti jugosllav Aleksandri më 6 të atij muaji, lajm që e përditshmja “Zora” e kishte publikuar që të nesërmen. Letra mbaronte me P.S, ku kërkonte falje sepse s’kishte kuptuar çfarë do të thoshte “mistifikim me finesë”.

Letrën e lexova disa herë, e mbaja në duar, i merrja erë, me shpresën të zbuloja ndonjë shenjë ironie. Më kot. Nëse kjo ishte lojë, Gaustini më ftonte të hyja pa asnjë saktësim të rregullave. Epo mirë, vendosa të luaja. Meqë s’kisha asnjë njohuri për vitin e mallkuar 1929, m’u desh të kaloja tri ditët në vazhdim në bibliotekë, duke gërmuar

³ Drejtshkrimi i vjetër bullgar.

periodikët e vjetër të gazetës “Zora”. Lexova me kujdes për mbretin Aleksandër, u hodha një sy për çdo rast dhe ngjarjeve që priteshin të ndodhnin: “Troçki i dëbuar nga BRSS”, “Gjermanët pranojnë paktin Kellogg–Briand”, “Musolini nënshkruan marrëveshje me Papën”, “Franca i refuzon Troçkit strehimin politik”, një muaj më vonë “Gjermania i refuzon Troçkit strehimin politik”. Shkova deri tek “Falimentimi i Wall Street” i datës 24 tetor. Që në bibliotekë i shkrova një përgjigje të shkurtër (dhe siç m’u duk mua, të ftohtë), Gaustinit ku ndaja mendimin tim (i cili çuditërisht, përputhej me atë të botuesit, z. Krapçev) lidhur me ngjarjet e Jugosllavisë dhe iu luta të më dërgonte gjërat mbi të cilat po punonte, me shpresën të kuptoja se çfarë po ndodhte në të vërtetë.

Letra e tij e ardhshme mbërriti pas një muaji e gjysmë. Kërkonte ndjesë sepse kishte kaluar një grip të fortë dhe s’mund të bënte asgjë. Mes të tjerash kërkonte mendimin tim nëse Franca do ta pranonte Troçkin. Për një kohë të gjatë mendoja nëse duhej t’i jepja fund kësaj historie dhe t’i shkruaja një letër të qartë, por vendosa të vazhdoja edhe pak. I dhashë disa këshilla lidhur me gripin, për të cilat ai vetë kishte lexuar në “Zora”, e këshillova të mos dilte shumë nga shtëpia dhe çdo mbrëmje t’i mbante këmbët në ujë të ngrohtë, me shumë kripë. Unë dyshoja shumë se Franca do t’i jepte strehim politik Troçkit, madje edhe Gjermania. Kur mora letrën e tij në vazhdim, Franca vërtet e kishte refuzuar Troçkin dhe Gaustini më shkruante me adhurim se “kisha nuhatje të jashtëzakonshme politike”. Kjo letër ishte më e gjatë se paraardhëset, për shkak të dy gjërave qw e kishin

entuziazmuar po ashtu. Njëra për poezitë e Bagrjanës, të sapobotuara në numrin e katërt të revistës “Zlatorog”, tjetra për një radioaparaturë të markës “Telefunken”, që përpiquej të ndreqte. Për këtë më kërkonte t’i dërgoja një llambë radioje “Valvo” nga magazina e Xhabarov-it në rrugën Aksakov, 5. Shkruante gjerë e gjatë për një prezantim në Berlin, të një aparaturës me 12 llamba të dr. Reiser, që transmetonte në valë të shkurtra falë rregullimit automatik të evaneshencës. “E beson se me të mund të dëgjosh edhe koncerte që nga Amerika?”.

Pas kësaj letre vendosa të mos përgjigjem. Edhe ai s’më shkroi më. As për Vitin e Ri, as për vitin e ri tjetrin. Pak e nga pak kjo historia u zbeh dhe. nëse s’ishin ato pak letra që i ruaj akoma, me siguri as unë s’do ta besoja. Por ndryshe ishte shkruar. Disa vite më vonë, përsëri mora një letër nga Gaustini. Kisha parandjenja të këqija dhe s’nxitoja me përgjigjen. Mendoja, a thua, i ka ardh’ mendja pas kaq kohësh, ose gjërat janë thelluar. Zarfina e hapa në mbrëmje. Brenda kishte vetëm disa rreshta. Po i citoj fjalë për fjalë:

Ndjesë se po të shqetësoj sërish pas kaq shumë kohe. Por ti vetë po shikon çfarë po ndodh përreth. I lexon gazetat dhe me nuanjat tëndë politike, me siguri, e ke parandier tashmë kasaphanën, e cila është në prag. Gjermanët po grumbullojnë masivisht ushtarë në kufirin polak. Deri tani s’ka kam përmendur se nëna ime është hebreje (kujto se çfarë ndodhi vitin e kaluar në Austri, apo “Kristallnacht” në Gjermani) ky s’ka për t’u ndalur përpara asgjëje. Kam

vendosur dhe kam bërë gjithçka të duhur për t'u nisur nesër në mëngjes me tren në Madrid, pastaj në Lisbonë dhe prej andej në New York...

Mirupafshim, tani për tani.

I yti, Gaustin

14 gusht 1939

Sot është 1 shtator.

6.

Më 1 shtator 1939 Wistan Hugh Auden zgjohet në New York dhe shkruan në ditarin e tij:

U zgjova me dhimbje koke pas një nate ëndrrash të këqija, në të cilat Ç-ja më tradhtonte. Gazetat shkruajnë se Gjermania sulmoi Poloninë...

Ja: kjo e gjitha në një fillim të vërtetë- ëndrra të këqija, luftë dhe dhimbje koke.

Ndodhesha në bibliotekën e New York-ut, kur u ndesha me këtë shkrim në ditarin e Auden-it, i cili ruhet në Londër, por për fat arkivi i tij ekspozohet këtu.

Vetëm ditari mund të takohet kështu personalisht dhe historikisht. Bota sot s'është e njëjta. Gjermania sulmon Poloninë, lufta fillon, koka më dhemb, ndërsa ky idioti Ç-ja pati paturpësinë të më tradhtonte në ëndërr. Sot në ëndërr, nesër në dritën e diellit (thua e pat menduar?). Me të

mësuar tradhtinë, të kujtojmë se Shahriari fillon masakrën e madhe të grave në “Një mijë e një net”. A thua Auden-i kuptonte sa shumë gjëra regjistrinin ato dy rreshta, sa të sakta, personale dhe cinike janë. Dy rreshta janë për ditën më të rëndësishme të shekullit. Po atë ditë, kur dhimbja e kokës fillon të largohet lehtë pak e nga pak, ai do të fillojë të hedhë disa vargje:

*I sit in one of the dives
On Fifty-second Street
Uncertain and afraid...⁴*

Dhe këtu tashmë pijetorja e 52-shit, dhimbja e kokës, tradhtia dhe ëndrra e keqe, sulmi mbi Poloninë në atë 1 shtator, e premte, gjithçka është bërë histori. Poema do të quhet pikërisht kështu: *1 shtator 1939*.

Kur bëhet histori e përditshmja?

Një sekondë të lutem. Ai vargu i shumë cituar *We must love one another or die*⁵ nga mbyllja e poemës, që Audeni pastaj nuk e pëlqente edhe aq dhe vazhdimisht e hiqte, a s’lidhet pikërisht me këtë tradhtinë e ëndrrës? E kush vallë do të dëshironte të kujtonte makthe të ngjashme?

Do të doja të dija gjithçka për atë ditë, një ditë nga vjeshta e 1939-ës, i ulur në kuzhinat e botës me këdo, të shikoja

⁴ Jam në një pijetore/në Fifty second Street/I trembur dhe i pasigurt... (përkth. Aleksandër Shurbanov)

⁵ Të duam njëri-tjetrin, apo të vdesim

gazetën që ata kanë hapur teksa pinë kafënë, për të lexuar me etje çdo gjë, duke filluar nga trupat e grumbulluara në kufirin gjermano-polak e deri tek ditët e fundit të shitjeve verore dhe lokali i ri Chinzano, i cili hapet në Lower Manhattan. Tashmë vjeshta është në prag. Hapësirat e reklamave nëpër gazeta, të parapaguara paraprakisht, tani janë fqinje me lajmet shkurt të orëve të fundit në Europë.

7.

Në një shtator tjetër, jam ulur në bar, në Brayant Park, pijetorja në 52 ka kohë që s'ekziston, sapo kam ardhur nga Europa dhe jam i lodhur (edhe shpirti ka gjithashtu *jet lag-un*⁶ e vet) dhe po shikoj fytyrat e njerëzve. Kam marrë vëllimin e vogël të Auden-it, gjithsesi i detyrohemi njëri-tjetrit një ritual. Mjerisht. Pas një dite të kaluar në bibliotekë, jam “I frikësuar dhe i pasigurt”. Nuk fjeta mirë, nuk pashë tradhti në ëndërr, apo pashë, por e kam harruar... Bota është në të njëjtë shkallë trazimi, sherifi vendas dhe sherifi i një vendi të largët e kërcënojnë njëri-tjetrin. E bëjnë në Twitter, brenda një kufiri karakteresh. Mungon retorika e vjetër, nuk ka elokuencë. Një çantë, një buton dhe... fundi i ditës së punës për botën. Apokalipsi i burokracisë.

⁶ Ndjenja e lodhjes dhe konfuzionit pas një udhëtimi të gjatë me avion në një vend ku koha është e ndryshme nga vendi i nisjes.

Po, s'janë më pijetoret e vjetra dhe mjeshtrit e vjetër, lufta, që pritej të ndodhte atëherë, ka kaluar edhe ajo, edhe të tjera luftëra kanë kaluar, vetëm trazimi ka mbetur.

I tell you, I tell you, I tell you we must die.

Diku afër dëgjohej kënga e “Doors” dhe papritur m'u duk se këtu ka një bisedë të fshehtë, se Morrison, në fakt po flet me Audin-in. Pikërisht ky refren, kjo replikë sikur zgjidh dyshimin e vetë Audin-it në atë varg të papëlqyer. *We must love one another or die.* Tek Morrisoni mungon dyshimi, përgjigja është kategorike *I tell you we must die.*

Duke gërmuar, pas njëfarë kohe zbulova se kënga është shkruar nga Brehti në 1925, me muzikë të Kurt Vajlit. Vetë ai e këndon gjatë 1930-ës në një mënyrë të mahnitshme, gati shokuese. ..Kjo i bën gjërat edhe më shumë të ndërthurura. Audini e ka marrë dhe kthyer vargun e Brehtit dhe në fakt flet me të. Brehti i vitit 1925 dhe Morrison i vitit 1969 u nisën në gjurmët e vdekjes *Unë ju them se duhet të vdesim.* Në sfondin e tyre Audini tingëllon sikur akoma jep shans *Të duhemi apo të vdesim.* Vetëm përpara luftërave, madje në vigjiljen e tyre, njeriu është i prirur të shpresojë. Në 1 shtator, me siguri, bota ende mund të shpëtohej.

Mbërrita në New York me urgjencë, siç zakonisht vihet në New York, duke i ikur diçkaje dhe duke kërkuar një gjë tjetër. Largohesha nga kontinenti i së shkuarës drejt një vendi që dëshmonte se s'ka pasur të shkuar, megjithëse ndërkohë e kishte grumbulluar. Mbaja me vete një bllok të verdhë, kërkoja një njeri, doja të tregoja, sa kohë s'më kishte lënë kujtesa.

8.

Disa vite më parë isha në një qytet ku s'ka pasur 1939. Një qytet i mirë për të jetuar dhe akoma më i mirë për të vdekur. Qytet i qetë, si varrezë. A mërzhitesh, më pyesnin në telefon. Mërzhia është emblema e këtij qyteti. Në të kanë ndjerë mërzhinë Canetti, Joyce, Dürrenmatt., Frisch, madje edhe Thomas Mann. Pak e pakëndshme ta matësh mërzhinë me ta. Nuk mërzhitem, përgjigjesha. Kush jam unë që të mërzhitem. Megjithëse fshehtas dëshiroja të provoja luksin e mërzhisë.

Kaloi kohë që kur humba gjurmët e Gaustinit në Vjenë. Prisja të jepte një shenjë prej dikund, shfletoja faqet e gazetave më pak të lexuara, por ishte e qartë se ai ishte bërë më i kujdesshëm. Një ditë mora një kartolinë pa emër dhe pa adresë të dërguesit. *Të fala nga Zyrihu. Kam menduar diçka. Nëse bëhet, do të të shkruaj.* Vetëm prej atij mund të ishte. Në muajt në vijim nuk shkroi asgjë, u nguta të pranoj ftesën për një qëndrim të shkurtër tek Literaturhaus-i i atjeshëm.

Kështu, kisha gati një muaj këtu, bridhja rrugëve të zbrazëta, të dielën, i gëzohesha diellit që qëndronte më gjatë në kodër dhe mund të shihje se si në perëndim, larg në fund të peizazhit, majat e Alpeve ndryshonin ngjyrat e tyre në një vjollcë të ftohtë. E kuptova pse në fund të jetës të gjithë vinin këtu. Zyrihu është qytet i mirë për pleqërim. Gjithashtu edhe për të vdekur. Nëse ka ndonjë gjeografi Europiane të moshës ajo duhet të ndahet kështu. Parisi, Berlioni dhe Amsterdami për rininë, për atmosferën aspak formale, për erën e hashashit, pirjen e birrës në Parkun

Mayer, rrotullimit në bar, tregjet e të dielës së mallrave të përdorura, lirinë e seksit...Pastaj vjen pjekuria e Vjenës, ose e Brukselit. Ulja e ritmit, rehatia, tramvajet, siguracionet e vlefshme të shëndetit, shkollat për fëmijë, pak karrierë, euroadministrata. Epo mirë, për ata që akoma s'duan të plaken – Roma, Barcelona, Madridi...Ushqimi i mirë dhe pasditet e ngrohta do të kompensojnë trafikun, zhurmën dhe kaosin e lehtë. Rinisë së vonshme do t'i shtoja edhe New Yorkun, e numëroj si qytet European, në lidhje me rastësitë e rrethanave të vendosura përtej oqeanit.

Zyrihu është qyteti i pleqërimit. Bota është ngadalësuar, lumi i jetës ka rënë në baltën e liqenit, qetësi në sipërfaqe, luks i mërzhisë dhe diell në kodrën për kockat e plakura. Kohë në të gjithë relativitetin e saj. Jo rastësisht, se dy zbulime të shekullit XX-të, që lidhen pikërisht me kohën, kanë ndodhur pikërisht këtu në Zvicër - “Teoria e Relativitetit” nga Einsteini dhe “Mali Magjik” i Thomas Mann-it.

S'kisha ardhur për të vdekur në Cyrih, akoma jo, ecja rrugëve, kisha nevojë për këtë pauzë, përpiquesha të mbaroja një roman, i cili rridhte gjak i lënë përgjysmë dhe shpresoja të takoja Gaustinin, ja ashtu, në trenin e vogël për Zürichberg ose në varrezat në kodrën e Flunternit, ulur pranë shtatores së Joyce-it. Atje kalova disa pasdite, tek Joyce me një cigare në dorë, këmbë mbi këmbë, me një libër të hapur në dorën e djathtë. Me vështrim të shkëputur nga libri për t'u dhënë kohë fjalimeve të përziera me tymin e cigares, me sy të picërruar pas syzeve, sikur do që ta ngrrejë kokën nga ty dhe të të flasë. E gjej si një nga shtatoret më jetësore mbi varr që kam parë. Kam qenë nëpër varrezat e botës, si

çdokush i frikësuar për vdekje nga vetë vdekja dhe fryma e fundit, (në fakt më shumë kemi frikë nga vdekja, apo fryma e fundit), që kërkon të shohë strofkën e frikës e të bindet se ky vend është i qetë, i paqtë, që gjithsesi është krijuar për njerëz, për pushim....Pak a shumë një vend për t'u mësuar. Megjithëse s'ka të mësuar. A s'është e çuditshme, më tha njëherë Gaustini, gjithmonë të tjerët vdesin, kurse ne vetë - kurrë.

9.

Kështu nuk e takova Gaustinin, as në varreza, as në *Seilbahn* afër Zürichberg. Qëndrimi im po përfundonte, ishim ulur në diell tek kafeneja Römerhof me një bullgare dhe po flisnim të shkujdesur, duke përdorur përparësinë e gjuhës së vogël, qetësinë që askush s'të kupton kur je duke marrë nëpër gojë tërë dynjanë. Komentuam me guximvizitorët e kafenesë dhe disa veçanti zvicerane deri tek trishtimi i përjetshëm dhe bezdia e të qenit bullgar, një temë e përshtatshme që mbush çdo pauzë të sikletshme të bisedës. Për bullgarin, të qahet është si të flasësh për kohën në Albion, nuk gabon asnjëherë.

Në këtë çast një zotëri i pashëm, i plakur bukur pranë nesh, që po pinte kafënë e tij, na u kthye me gjuhën më të ëmbël bullgare (i mirë dhe bullgar zakonisht nuk rimojnë) tha: Më falni se po ju dëgjoja, ngaqë jam afër, por kur dëgjoj bullgarishten e bukur s'mund t'i mbyll veshët.

Ka zëra që menjëherë të tregojnë histori, ky ishte një zë emigranti, nga emigracioni i vjetër, çuditërisht sesi e ruajnë pa theks atë bullgarishten e tyre, vetëm vende-vende disa zanore kishin mbetur në gjuhën e viteve '50 dhe '60, çka i jepte një oksidim të lehtë. Sikleti ynë si të zënë ngushtë u zbeh shpejt, tek e fundit s'kishim thënë asgjë të keqe për zotërinë.

Dhe nisi ajo lloj bisede mes bashkatdhetarësh të takuar rastësisht, roli im ishte më shumë se ai i të dëgjuarit. Kaloi një orë, por çfarë është një orë për vitet e munguara, dama jonë kërkoi ndjesë dhe u largua, ne u ulëm në një tavolinë, a keni pak durim, sa ta mbaroj këtë histori dhe ikim, sigurisht që kisha. Kur nisëm bisedën diellin po dremiste në vitrinat e kafenesë dhe mbi orën, e cila tregonte tri pasdite, pastaj hijet e gotave u zgjatën, hijet tona gjithashtu, fresku i mbrëmjes po afrohej, por pa nxituar na falte kohë për të përfunduar një histori, të gjatë, më shumë se pesëdhjetë vite.

Ishte njeri me mendim absolut të saktë, diku ndalonte për të gjetur fjalën e përshtatshme. *Jo, tani po përkthej nga gjermanishtja, prisni pak, do t'më vijë, ja, kjo është fjala...*dhe vazhdonte më tej. Djalë i një shkrimtari dhe diplomati bullgar të harruar, me fëmijëri në prag lufte nëpër ambasadat në Europë. Pata dëgjuar për të atin, gjë që e gëzoji, pa e shprehur dukshëm. Pastaj vjen historia klasike bullgare pas vitit 1944, i ati pushohet nga puna, dënohet, e çojnë në kampin e përqendrimit në Belene, torturohet, trembet, shtypet; apartamenti i tyre konfiskohet dhe i jepet një shkrimtari “të duhur”, kurse familja e tyre dërgohet diku në periferi të qytetit.

Babai nuk më tregoi kurrë për çka i ndodhi në kamp, tha bashkëbiseduesi im, le ta quajmë zoti S. Vetëm njëherë nëna ime kishte zierë patate dhe kërkoi falje se ndoshta ishin të paziera mirë, kurse ai mëmëriti: *Nuk ka gjë, i kam ngrënë edhe të gjalla, kam gërmuar si derr i egër në tokë.* Dhe heshti sërish, si njeri që ka thënë më shumë seç duhet. Pastaj edhe vetë zoti S, siç edhe pritej hyri në burg për 15 muaj, e para, si djalë i babait dhe e dyta, sikundër pritej, pas trazirave në Hungari.

Pastaj jeta e tij sikur u stabilizua. I tha vetes se s'do mendonte për burgun, për spiunët që vazhdonin ta ndiqnin, por një natë, duke pritur tramvajin e fundit, qëndroi përpara një vitrine krejtësisht bosh dhe ia nguli vështrimin. Një poç i vetëm me kablllo varej nga lart dhe hidhte një dritë të zbehtë.

Një poç, një kablllo dhe një vitrinë e zbrazët.

Nuk i shkëpuste dot sytë. Dëgjoi si nëpër ëndërr tramvajin tek qëndroi gjithë zhurmë, priti pak, pastaj mbylli dyert dhe u nis. Qëndroi dhe shihte dritën e poçit të thjeshtë elektrik, lëshuar poshtë si i varur. *Atëherë m'u ndez llamba, tha ai, ajo që e pata fshehur edhe nga vetja, se duhet të largohem. M'u ndez llamba, përsëriti ai dhe qeshi. Ishte 17 shkurt 1966, isha 33 vjeç.*

Që këtej e tutje gjithçka iu nënshtrua këtij mendimi, kishte një plan. Të ndërronte punën me një tjetër ku kërkonin punëtorë për Gjermaninë Lindore. Pa rënë në sy të ndahej me të gjithë. Fillimisht me shokun më të mirë, pastaj me gruan që kishte lidhje. Nuk e dha veten përpara askujt, madje as në shtëpi. Vetëm i ati, i tha *kujdes* në nisje dhe e përqafoi më gjatë se zakonisht. Ndërsa e ëma hodhi